## Të vërtetat e trafikimit

Trafikimi i personave është një krim dhe shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Çdo vit, mijëra burra, gra dhe fëmijë bien në duart e trafikantëve. Pothuajse çdo vend në botë është i prekur nga trafikimi, qoftë si vend origjine, tranzit ose destinacioni për viktimat.

Trafikimi përfshin forma të ndryshme të shfrytëzimit: detyrimin e viktimave në prostitucion, nënshtrimin e viktimave në skllavëri ose në robëri të pavullnetshme, punën e detyruar, lypje, heqjen e organeve dhe forma të tjera të shfrytëzimit.

Sipas UNODC-së trafikimi i qenieve njerëzore është industria e tretë më e madhe ndërkombëtare e krimit (pas drogës dhe trafikimit të armëve). Përllogaritet se gjeneron një fitim prej 32 miliardë dollarësh çdo vit.







Skllavëria në kuptimin më të ngushtë të termit është apo quhet çdo sistem në të cilin parimet e ligjit të pronësisë zbatohen për njerëzit, duke lejuar individë të caktuar të posedojnë, shfrytëzojnë, blejnë dhe shesin individë të tjerë.

Skllavëria është një fenomen që vazhdon ende në ditët e sotme. Nga statistikat rezulton se më shumë se 27 milionë persona vuajnë nga trafikimi çdo ditë.

**Organizata "Të Ndryshëm & të Barabartë"**
**Linja e këshillimit ligjor për viktimat e krimit**

+355 4 2200 400
+ 355 67 2200 400

# MOS I VËR ÇMIM JETËS TIME!

## TRAFIKIMI VRET!

Të gjithë mund të bëjmë diferencën!
Skllavëria është mizoria e jetës!
Liria i përket gjithsecilit!
Bashkoju sfidave!




Broshura u përgatit nga Grupi i të Rinjve Pogradec në kuadër të projektit "Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata anti-trafikimi", i financuar nga "Arise Fondation" dhe zbatuar nga Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

Përmbajtja e këtij materiali jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e "Arise Fondation" dhe Organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

## EKZISTOJNË KATËR FORMA MË TË NJOHURA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE:

### Trafikimi për punë të detyruar



### Trafikimi për shfrytëzim seksual




### Trafikimi për transplant organesh



### Trafikimi për lypje



## Ndihma ndaj viktimave të trafikimit

Ndihma për viktimat e trafikimit jepet në mënyrë të pakushtëzuar dhe konsiston në këto shërbime:

- strehim të përshtatshëm dhe të sigurt;
- ndihmë psikologjike;
- informim për mundësitë e ndihmës;
- ndihmë materiale;
- akses në shërbimin mjekësor;
- shërbimet e përkthimit;
- këshillim dhe mbështetje në familje;
- ndihmë ligjore falas;
- akses në tregun e punës, formimin dhe arsimin profesional.



## Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e trafikimit

**Faktorët ekonomikë:**
ekonomi e shkatërruar, papunësi e madhe, varfëri, etj.

**Faktorët social:**
martesat e pamenduara, divorcet, dhuna në familje, mungesa e perspektivës për të ardhmen, niveli i ulët arsimor, etj.

**Faktorët politikë:**
mungesa e stabilitetit politik dhe institucional, korrupsioni, lidhja e politikës me krimin etj.



**ARRITJE**

Different & Equal
Ne mund të sjellim ndryshimin!
Kemi një mundësi për të ndihmuar!
Trafikimi nuk është një problem i zakonshëm.